

Paris, më 7 shkurt 2020

Zoti Kryeministër, i dashur mik,

Në emrin tim dhe në emër të popullit francez, ju dërgoj përgëzimet e mia të sinqerta dhe urimet e mia më të mira për sukses në ushtrimin e përgjegjësive tuaja të reja si Kryeministër i Republikës së Kosovës.

Franca, e cila ishte vendi i dytë që njohu Kosovën si një shtet të pavarur, një ditë pas shpalljes së pavarësisë 12 vjet më parë, ka qëndruar në anën e saj që nga ajo kohë.

Qeveria që ju drejtoni, e dalë nga zgjedhjet e 6 tetorit 2019, mishëron një alternativë politike dhe një shpresë. Dëshiroj të përshëndes angazhimin tuaj për të adresuar sfidat kryesore, me të cilat përballet Kosova: zhvillimi ekonomik dhe shoqëror dhe konsolidimi i shtetit të së drejtës, veçanërisht lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Franca do t'ju mbështesë në këto reforma në shërbim të qytetarëve të Kosovës dhe përafrimit evropian të vendit tuaj. Bashkëpunimi ynë i dendur dhe i larmishëm dypalësh, do të mbështetet së shpejti edhe nga vendosja në Kosovë e Agjencisë Franceze të Zhvillimit, çka është një shembull konkret i riinvestimit të Francës, të cilin e kam dëshiruar, në Ballkanin Perëndimor.

Ju gjithashtu mund të mbështeteni në angazhimin tim për normalizimin e plotë të marrëdhënieve midis vendit tuaj dhe Serbisë, që është një sfidë tjetër e madhe për të ardhmen e Kosovës dhe një sfidë për sigurinë evropiane. Në muajin korrik të vitit të kaluar, unë u bëra thirrje serbëve dhe kosovarëve që të veprojnë si evropianë duke kërkuar një kompromis.

Hapi i parë natyrisht që duhet të jetë rifillimi i dialogut, të cilin unë jam i gatshëm ta lehtësoj duke organizuar në Paris, së shpejti, një samit me udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë, së bashku me Kancelaren Merkel dhe Përfaqësuesin e Lartë Borrell. Rifillimi i dialogut nënkupton veprime nga të dyja palët: pezullimi nga Kosova i taksës 100% për produktet nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina; dhe pezullimi nga Serbia të fushatës së saj për "çnjohjen" e Kosovës.

Shkëlqesia e tij, zoti Albin Kurti,  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Pasi të rifillojë dialogu, do t'i takojë BE-së, përmes ndërmjetësimit të saj të mbështesë përpjekjet tuaja për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse, përfundimtare dhe ligjërish obliguese me Serbinë. Franca do t'i mbështesë në mënyrë aktive këto përpjekje. Ju ftoj të tregoni guxim politik të nevojshëm për t'u angazhuar vendosmërisht në këtë rrugë të paqes dhe prosperitetit për Kosovën, Ballkanin dhe Evropën më gjerësisht.

Duke shpresuar t'ju takoj së shpejti, dhe duke ju shprehur edhe një herë urimet e mia për sukses në detyrën tuaj të re, ju lutemi pranoni, zoti Kryeministër, sigurinë e vlerësimit tim shumë të lartë.

*Faleminderit shumë për librin që më ka prekur shumë*

*Mirupafshim për së shpejti*

*Përzemërisht,*

*Emmanuel Macron.*

Emmanuel Macron

Paris, le - 7 FEV. 2020

Monsieur le Premier ministre,

Je vous adresse, en mon nom et au nom du peuple français, mes sincères félicitations et mes vœux de réussite dans l'exercice de vos nouvelles responsabilités de Premier ministre de la République du Kosovo.

La France, qui a été le deuxième pays à reconnaître le Kosovo comme Etat indépendant, au lendemain de sa déclaration d'indépendance il y a onze ans, se tient depuis lors à ses côtés.

Le Gouvernement que vous dirigez, issu des élections du 6 octobre dernier, incarne une alternance politique et un espoir. Je tiens à saluer votre engagement à relever les principaux défis auxquels fait face le Kosovo : le développement économique et social et la consolidation d'un Etat de droit, en particulier la lutte contre la criminalité organisée et la corruption. La France vous soutiendra dans ces réformes au service des citoyens du Kosovo et du rapprochement européen de votre pays. Notre coopération bilatérale, dense et variée, pourra prochainement s'appuyer sur l'intervention au Kosovo de l'Agence française de développement, qui est une illustration concrète du réinvestissement, que j'ai souhaité, de la France dans les Balkans occidentaux

Vous pouvez également compter sur mon engagement en faveur de la normalisation complète des relations entre votre pays et la Serbie, qui constitue un autre défi majeur pour l'avenir du Kosovo et un enjeu de sécurité européenne. En juillet dernier, j'ai appelé Serbes et Kosovars à agir en Européens en recherchant un compromis.

La première étape doit, bien sûr, être la reprise du dialogue, que je suis prêt à faciliter en accueillant, à Paris, prochainement, un sommet associant les dirigeants du Kosovo et de Serbie, avec la chancelière Merkel et le Haut-représentant Borrell. La reprise du dialogue suppose des gestes de part et d'autre : la suspension, par le Kosovo, de la taxe de 100% sur les produits en provenance de Serbie et de Bosnie-Herzégovine ; et la suspension, par la Serbie, de sa campagne de « dé-reconnaissance » du Kosovo.

Son Excellence Monsieur Albin Kurti  
Premier ministre de la République du Kosovo

Une fois que le dialogue aura repris, il reviendra à la médiation de l'UE de soutenir vos efforts pour parvenir à un accord global, définitif et juridiquement contraignant avec la Serbie. La France appuiera activement ces efforts. Je vous invite à faire preuve du courage politique nécessaire pour vous engager résolument dans ce chemin de paix et de prospérité pour le Kosovo, les Balkans et l'Europe plus largement.

En espérant vous rencontrer prochainement, et vous renouvelant mes vœux de succès dans vos nouvelles fonctions, je vous prie de croire, Monsieur le Premier ministre, à l'assurance de ma très haute considération.

Merci beaucoup pour la lettre qui  
m'a beaucoup touché!

Emmanuel MACRON

à bientôt

Tous cordialement

Emmanuel Macron

